



Përfundimet e Konferencës së Tiranës

Përforcimi i llogaridhënies - Fuqizimi i luftës kundër korrupsionit në Ballkanin Perëndimor -

Në datat 4 dhe 5 mars 2024, në Tiranë të Shqipërisë u organizua një konferencë ndërkombëtare për të shqyrtuar strategjitë rajonale në drejtim të përmirësimit të kulturës së integritetit me bazë në llogaridhënie në Ballkanin Perëndimor. Konferenca u organizua me bashkëpunimin e Ministrisë së Drejtësisë të Shqipërisë, ministres së Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe Inicativës Globale Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar dhe u mbështet nga Mbretëria e Bashkuar. Ky organizim shërbeu si platformë për të shkëmbyer përvojat, arritjet dhe sfidat midis ministrave të drejtësisë, zyrtarëve të nivelit të lartë në fushat e drejtësisë dhe të administratës publike, drejtorëve të agjencive rajonale të antikorrupsionit si dhe përfaqësuesve të institucioneve përkatëse rajonale dhe ndërkombëtare, të shoqërisë civile dhe të akademisë. Të gjitha palët e interesuara përsëritën përkushtimin e tyre ndaj luftimit të korrupsionit me anë të një qasjeje shumëplanëshe. Ato diskutuan rëndësinë vendimtare të llogaridhënies - si për vendimmarrësit, ashtu edhe për ekspertët e nivelit teknik - për të krijuar një themel të fortë në funksion të përparimit të agjendës së antikorrupsionit në nivelin kombëtar dhe rajonal.

Duke u mbështetur në përfundimet e konferencës së vitit 2022 në Shibenik, në konferencën e Tiranës u fol për një numër çështjesh kryesore, të cilat janë jetike për përforcimin e integritetit dhe llogaridhënies:

Udhëheqja dhe vullneti politik: Udhëheqja dhe vullneti politik janë parakushtet për krijimin dhe ruajtjen e kulturës së integritetit. Shumë pjesëmarrës theksuan se angazhimet për të luftuar korrupsionin kanë peshë vetëm nëse zbatohen. Për këtë arsye, politikanët dhe zyrtarët e lartë të administratës publike dhe sektori privat duhet të bëhen model që duhen ndjekur nga të tjerët. Në këtë mënyrë, jo vetëm që ulet rreziku i korrupsionit, por shtohet edhe besimi i qytetarëve tek institucionet dhe qeveritë e tyre.

Rritja e transparencës në lidhje me financimin politik: Iu kushtua vëmendje e veçantë çështjes së financimit politik dhe kërcënimit që i kanoset rajonit nga "[korrupsioni i organizuar](#)". Këtu përfshihet jo vetëm financimi i partive politike dhe i zgjedhjeve, por edhe ndikimi dhe kontrolli politik mbi ndërmarrjet shtetërore dhe përdorimi dhe kontrolli i prokurimit publik për qëllime politike. Pjesëmarrësit theksuan se transparenca, llogaridhënia dhe menaxhimi i përgjegjshëm i burimeve publike përbëjnë një të mirë publike dhe një mënyrë për të forcuar besimin midis qytetarëve dhe institucioneve publike. Më tej, u theksua se përforcimi i integritetit luan rol jetik në ngadalësimin e prirjeve drejt demokracive joliberalë dhe është parakusht për anëtarësimin në BE. Në të njëjtën kohë, u nënvizua se lufta kundër korrupsionit është sfidë botërore, që nuk kufizohet në një rajon ose sektor të caktuar dhe se rreziku i korrupsionit nuk përfundon me anëtarësimin e shtetit në BE. Prandaj, është vendimtare të krijohen mekanizma sistemikë të kontrollit dhe të ekuilibrit dhe të ofrohen arsim dhe praktika të mira me të cilat të përforcohen antitrupat shoqërorë kundër korrupsionit.

Sistemi i drejtësisë dhe autoritetet e zbatimit të ligjit: U theksua edhe roli i rëndësishëm që luan sistemi i drejtësisë penale, sidomos policia, prokurorët dhe institucionet gjyqësore dhe ato kundër korrupsionit. Pjesëmarrësit nënvizuan se autoritetet profesionale, të pavarura dhe llogaridhënese të drejtësisë dhe të zbatimit të ligjit janë thelbësore për zbatimin e ligjeve dhe për përfundimin e kulturës së integritetit. Efektiviteti i tyre shtohet nëpërmjet bashkëpunimit dhe bashkërendimit në të gjitha fazat e procedurave të antikorrupsionit. Pjesëmarrësit pohuan nevojën për përmirësimin e bashkëpunimit ndërkufitar, duke përfshirë këtu hetimet e përbashkëta, si me vendet brenda rajonit, ashtu edhe me partnerët në vendet ku veprojnë grupet kriminale me origjinë nga Ballkani Perëndimor.

Teknologjia si aleate në luftën kundër korrupsionit: Ndonëse ndihmon në veprimtaritë e krimit të organizuar, teknologjia mund të luajë një rol të rëndësishëm edhe në luftën kundër korrupsionit dhe në përmirësimin e sistemeve të llogaridhënies dhe të integritetit. Shtimi i digjitalizimit dhe risitë teknologjike ofrojnë mundësi të jashtëzakonshme për të shtuar transparencën, për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve dhe për të gjurmuar prirjet e korrupsionit në kuadër të proceseve të qeverisjes. Këto risi mund të kenë ndikim të madh sidomos në sektorët që janë më të ekspozuar ndaj korrupsionit, siç është sektori i ndërtimit, prokurimi publik dhe të drejtat pronësore. Ka shumë strategji kombëtare në rajon, që kanë të bëjnë me përdorimin e këtyre mjeteve për të përmirësuar transparencën dhe llogaridhënien.

Edukimi për parandalimin e korrupsionit dhe qasja me në qendër qytetarët: Ngulitja e kulturës së respektimit të ligjit, sidomos në radhët e të rinjve e të rejave, dhe vetëdijesimi i publikut në lidhje me dëmet që shkakton korrupsioni janë jetike për formësimin e shoqërive, të cilat, në themel të tyre, kanë integritetin dhe llogaridhënien. Gjatë konferencës u diskutuan praktikatat më të mira të rajonit dhe të botës në lidhje me edukimin kundër korrupsionit. Pjesëmarrësit theksuan se ndjekja e një qasjeje me qytetarët në qendër është thelbësore për informimin dhe fuqizimin e individëve, për forcimin e parandalimit dhe për krijimin e inercisë në drejtim të zbatimit të qëndrueshëm të agjendës antikorrupsion në rajon. Në këtë kuadër, u theksua rëndësia që paraqet angazhimi i shoqërisë civile. Më tej, u nënvizua nevoja për angazhimin e rinisë dhe përfshirjen e vullnetshme të saj në fushatat për parandalimin e korrupsionit dhe u diskutua dhe u nënvizua roli që luajnë gratë në fuqizimin e integritetit të institucioneve publike. Në mënyrë më të përgjithshme, u pohua se, megjë korrupsioni na prek të gjithëve, strategjitë kundër korrupsionit duhet të përfshijnë gjithë shoqërinë, me qëllim që të arrihen rezultatet e duhura.

Aspiratat për anëtarësimin në Bashkimin Evropian: Aspirata për t'u bërë pjesë e Bashkimit Evropian vazhdon të mbetet stimul i fuqishëm për vendet e Ballkanit Perëndimor që të çojnë më tej reformat për llogaridhënien dhe integritetin. Konferenca shërbeu si mundësi që vendet e rajonit të mësonin nga përvojat e shteteve anëtare dhe të institucioneve të BE-së dhe nga praktikatat më të mira të organizatave përkatëse rajonale dhe ndërkombëtare që merren me parandalimin e korrupsionit. Ajo që është më e rëndësishme është se, gjatë bisedave të shumta, u vunë në dukje sfidat e zakonshme me të cilat përballen vendet e rajonit dhe përvojat e ngjashme me pjesët e tjera të Evropës dhe të botës. Për pasojë, pjesëmarrësit nënvizuan nevojën për rritjen e bashkëpunimit rajonal dhe shtimin e shkëmbimit të informacioneve me shtete dhe institucione që kanë përvojë të konsiderueshme në fushën e përfundimit të integritetit në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe në sektorin privat e në atë publik.

Pikëpamje të ndryshme—një qëllim i përbashkët: Nga kontributet e aktorëve të shoqërisë civile, akademikëve, agjencive dhe institucioneve të posaçme të antikorrupsionit dhe nga praktikatat kombëtare doli se kishte një gamë të ndryshme qasjesh në lidhje me luftën kundër korrupsionit. Gjatë

konferencës, u përmendën standardet dhe zotimet ekzistuese, siç janë Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit (UNCAC) dhe mekanizmat e shqyrtimit të zbatimit, duke përfshirë mekanizmin e UNCAC-së, raundet e vlerësimit të Grupit të Shteteve Kundër Korrupsionit (GRECO) dhe “Udhërrëfyesin rajonal për luftën kundër korrupsionit dhe financave të paligjshme”. Ndonëse, në bazë të këtyre instrumenteve, ka një gamë të gjerë faktorësh dhe pikëpamjesh të ndryshme, në konferencë u theksua se ekziston një qëllim i përbashkët: lufta kundër korrupsionit dhe përforcimi i integritetit.

Si përfundim, pjesëmarrësit shprehën vlerësimin e tyre për konferencën e Tiranës dhe për organizatorët e saj. Ata shprehën interes për të përforcuar më shumë rrejet e veprimit, për të krijuar ura midis aktorëve të rëndësishëm dhe për të përmirësuar bashkëpunimin rajonal në kuadër të luftës kundër korrupsionit. U sugjerua që në të ardhmen të nxirreshin më shumë në pah sfidat dhe mundësitë e qeverisë lokale në kuadër të luftës kundër korrupsionit, fuqizimi i rolit të sistemit gjyqësor dhe të organeve të antikorrupsionit dhe mënyrat e bashkëpunimit të ngushtë dhe efikas me sektorin privat.